



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I JASHTËM I VLERËSIMIT**

Nr. 6/147 AKTI

NR. 117 VENDIMI

Tiranë, më 20.11.2019

**V E N D I M**

Trupi Vlerësues i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, i përbërë nga:

<b>Ela Kerka</b>	Kryesues
<b>Marjeta Gjelaj</b>	Relator
<b>Ana Kapaj</b>	Anëtar

asistuar nga anëtarët e Sekretariatit Teknik, Kozeta Jana dhe Gent Pejo, më datë 5 Nëntor 2019, ora 12.00`, në Tiranë, në Pallatin e Kongreseve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I VLERËSIMIT:** **Z. Oltion Shehu**, Shef i Sektorit të Trajtimit të Ankesave në Drejtorinë Rajonale të SHÇBA Tiranë, i përfaqësuar nga avokat Adenis Cullhaj, me numër license 3431, me prokurë të posaçme me nr. 4009 rep, nr. 1779 kol, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë.

**OBJEKTI:** **Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit**

**BAZA LIGJORE:** **Ligji Nr.12/2018**, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar,

**Ligji nr.44/2015** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e

gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI VLERËSUES I KOMISIONIT TË JASHTËM TË VLERËSIMIT,**

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Marjeta Gjellaj, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i vlerësimit, shqyrtoi dhe analizoi çështjen, duke u bazuar në të tria kriteret e vlerësimit, atë pasuror, të figurës dhe vlerësimin profesional, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, të ligjit 12/2018 të ndryshuar,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit është organi që bën vlerësimin kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, bazuar në pikën 1 të nenit 5, dhe në pikat 1 dhe 5, të nenit 6, të ligjit Nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, të ndryshuar.

2. Z. Oltion Shehu, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Inspektimit të Ankesave në SHÇBA. Për këtë shkak, bazuar në nenin 6 të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, i është nënshtruar procesit të vlerësimit, duke u shortuar me datë 03.06.2019, në përputhje me “Rregulloren për Procedurat e Zhvillimit të Shortit në Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit”.

3. Në hedhjen e shortit të datës 03.06.2019, u përzgjedh kryesuese u trupës së vlerësimit znj. Ela Kerka. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit vlerësues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ me qëllim kryerjen e procedurave të vlerësimit për subjektin e vlerësimit.

4. Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat me datë 24.06.2019 njoftoi<sup>1</sup> Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit për lirimin e z. Shehu nga detyra e drejtorit dhe emërimin e tij në pozicionin e Specialistit të Analizës dhe Kartotekës në Drejtorinë e Hetimit në SHÇBA.

5. Me datë 08.08.2019, z. Shehu është emëruar Shef i Sektorit të Trajtimit të Ankesave në Drejtorinë Rajonale të SHÇBA-së Tiranë.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht me nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

---

<sup>1</sup> shkresa nr. \*\*\*\* Prot, datë 24.06.2019

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun IV, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht me nenin 35 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të vlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimin e atyre që janë përfshirë apo kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në veprimtari kriminale.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun V, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht me nenin 43 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me pozicionin, respektimin e rregullave të etikës, si dhe të përmbushjes së detyrave nga punonjësi në përputhje me ligjin që rregullon veprimtarinë e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

9. Bazuar në dispozitat e ligjit nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, të ndryshuar, pranë Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit janë administruar dokumentat shkresor të hartuar nga institucionet apo personat juridikë, publikë apo privat të cilët sipas këtij ligji detyrohen të japin të dhëna për subjektet e vlerësimit.

10. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret, atë të vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

11. Trupi vlerësues, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 14.10.2019, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tri kriteret për subjektin e vlerësimit, z. Oltion Shehu; (ii) njoftimin e subjektit të vlerësimit për t`u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

12. Gjithashtu, subjekti i vlerësimit, në datën 22.10.2019, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë, apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i vlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 25.10.2019, dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 31.10.2019.

12. Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi vlerësues, vendosi të ftojë subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

13. Subjekti i vlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, në datën 31.10.2019.

14. Seanca dëgjimore me subjektin e vlerësimit, z. Oltion Shehu, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr.12/2018, "Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme", në datën 5.11.2019, ora 12.00`, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0.

15. Në seancën dëgjimore të datës 5.11.2019, subjekti i vlerësimit u paraqit personalisht dhe u përfaqësua me përfaqësues ligjor avokat Adenis Cullhaj, i cili mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e vlerësimit të kryer ndaj subjektit të vlerësimit z. Oltion Shehu. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, avokat Adenis Cullhaj, kërkoi për subjektin e vlerësimit konfirmimin në detyrë.

### **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

14. Z. Oltion Shehu ka qenë bashkëpunues gjatë procesit të vlerësimit, duke u përgjigjur brenda afatit të përcaktuar, sipas pikës 2, të nenit 48, të ligjit nr.12/2018, "Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme".

### **IV. PROCESI I VLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I JASHTËM I VLERËSIMIT**

Procesi i vlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, është një proces që mbështetet në ligjin nr.12/2018, të ndryshuar.

#### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

Bazuar në nenet 48, 51 dhe 52 të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e vlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) deklaratat e dorëzuara nga subjekti për procesin "Vetting", pranë SHÇBA.
- b) deklaratat e pasurisë të dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së, në periudhën që ka qenë subjekt deklarimi pranë këtij institucioni;
- c) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 51 dhe 52 të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar;
- ç) deklaratimet e subjektit të vlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit;
- dh) deklaratimet e personit të lidhur dhe të personave të tjerë të lidhur;

Në deklaratën e pasurisë "Vetting", të dorëzuar pranë SHÇBA-së në datën 02.05.2018, subjekti i vlerësimit, z. Oltion Shehu, deklaroi këto pasuri (të paluajtshme dhe të luajtshme) në emër të tij:

**1. Shtëpi banimi**, 2 katëshe me sip.161m<sup>2</sup>, Rruga "\*\*\*\*\*", nr.\*\*\*, Njësia Bashkiake Nr.\*\*\*, Tiranë.

Burimi i krijimit të pasurisë;

- ✓ Kredi BKT shuma 500 000 lekë, disbursuar me 08.08.2007,
- ✓ Kredi nga Raiffeisen Bank shuma 1 000 000 lekë,
- ✓ Kursime familjare 2 500 000 lekë,
- ✓ Vlera totale: 4 000 000 Lekë (Katër milion).
- ✓ Pjesa në %:100%.

Në lidhje me këtë shtëpi banimi subjekti i vlerësimit ka vënë në dispozicion:

- Leje Legalizimi nr.\*\*\*\*\*, datë 17.08.2015.
- Për kursimet familjare nuk ka vënë në dispozicion asnjë dokument.

Nga hetimi administrativ rezultoi se:

Agjencia Shtetërore e Kadastrës<sup>2</sup> ka konfirmuar se shtetasi Oltion Kapllan Shehu është pajisur me lejen e legalizimit nr.\*\*\*\*\*, datë 17.08.2015.

Sipas akteve noteriale<sup>3</sup>, rezultoi se subjekti i vlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë hequr dorë nga procesi i legalizimit të pasurisë nr.\*\*\*\*\* në zonën kadastrale \*\*\*\*\*, e ndodhur në Njësinë Bashkiake nr.\*\*\*\*\*, duke kaluar të drejtën e pronësisë së objektit të tyre në rrugën \*\*\*\*\* tek shtetasit K. Sh dhe Sh. Sh.

I pyetur nga Relatori për arsyen e heqjes dorë nga pasuria e deklaruar në deklaratën Vetting 2018, subjekti sqaron si vijon:

*Kjo shtëpi ka filluar të ndërtohet në vitin 2003 dhe ka përfunduar në vitin 2008. Përpara vitit 2000 kam jetuar në shtëpinë e prindërve, banesë dy katëshe. Në katin e parë ka jetuar familja ime dhe në katin e dytë ka jetuar familja e xhaxhit M.Sh. Në zbatim të ligjit Nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” unë, babai im K.Sh dhe xhaxhai M.Sh kemi dorëzuar pranë Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tiranë, formularët e Vetëdeklarimit për të dy objektet e ndërtuara pa leje. Unë dhe xhaxhai M.Sh kemi plotësuar formularin për shtëpinë e ndërtuar përpara vitit 2000, ndërsa babai ka plotësuar formularin për shtëpinë që ka filluar të ndërtohet në vitin 2003, në të cilën ky i fundit dhe ka jetuar për një periudhë të shkurtër kohe sepse unë me familjen time jetonim në Kombinat. Në vitin 2008 unë me familjen time kemi shkuar të banojmë në shtëpinë e re. Në vitin 2009 unë dhe babai im kemi rënë dakort për të shkëmbyer pronësinë e shtëpive në mënyrë respektive.*

Sipas aktit noterial<sup>4</sup> rezulton se babai i subjektit shtetasi K.SH, ka hequr dorë nga pasuria shtëpi banimi e ndërtuar në vitin 2003 në Rr. \*\*\*\*\*, Njësia Bashkiake nr. \*\*\*\*\*, Tiranë, për të cilën ka paraqitur kërkesë për legalizim, dosjen nr.\*\*\*\*\* prot, datë 24.03.2005, të legalizohet në emër të djalit të tij, Oltion Shehu.

<sup>2</sup> shkresa nr.\*\*\*\* Prot, datë 12.07.2019.

<sup>3</sup> akti nr\*\*\*\*\*Rep, nr\*\*\*\*Kol, datë 28.07.2015 dhe akti nr\*\*\*\*\*Rep, nr\*\*\*\*Kol, datë 28.07.2015.

<sup>4</sup> akti nr\*\*\*\*\*Rep, nr\*\*\*\*Kol, datë 17.08.2015.

ZRPP Tirana Veri<sup>5</sup>, ka informuar komisionin se në emër të z. Oltion Shehu figuron e regjistruar pranë kësaj zyre pasuria ZK 8340, Vol 30, fq 147, ndërtesë me sipërfaqe 77.50 m<sup>2</sup>. *Çertifikata e Pronësisë është e shoqëruar me Kartelën e Pasurisë, e cila në seksionin e përshkrimit të pasurisë, përcakton se kjo pasuri vjen si rezultat i Lejes së Legalizimit me nr.\*\*\*\*\* datë 17.08.2015.*

Lidhur me burimet e krijimit të pasurisë nga hetimi administrativ rezultoi:

- BKT<sup>6</sup> ka konfirmuar se janë disbursuar në llogarinë e subjektit të vlerësimit 490 000 lekë.
- Raiffeisen Bank<sup>7</sup> ka konfirmuar se janë disbursuar në llogarinë e bashkëshortes së subjektit A.Sh, 1 000 000 lekë.

Lidhur me kursimet familjare, Komisioni hetoi të ardhurat nga burime të ligjshme të familjes së subjektit të vlerësimit dhe rezultoi:

Nga të dhënat e Institutit të Sigurimeve Shoqërore<sup>8</sup> rezultoi se subjekti i vlerësimit ka qenë i punësuar:

- Pranë subjektit privat \*\*\*\* sh.p.k. për periudhën Janar 2003 - Tetor 2004 dhe ka pasur të ardhura neto në shumën 136 699 lekë.
- Pranë Degës së Tatimeve Tiranë për periudhën Mars 2006 - Qershor 2007 dhe ka pasur të ardhura neto 736 129 lekë.
- Pranë bankës \*\*\*\*\* për periudhën Shtator 2008 - Maj 2009 dhe ka pasur të ardhura neto në shumën 319 761 lekë.
- Pranë bankës \*\*\*\*\* për periudhën Maj 2009 - Shkurt 2011 dhe ka pasur të ardhura neto në shumën 876 405 lekë.
- Pranë Shërbimit përmbarimor \*\*\*\* për periudhën Shtator 2012 - Prill 2014 dhe ka pasur të ardhura neto në shumën 453 035 lekë.

Nga të dhënat e Institutit të Sigurimeve Shoqërore<sup>9</sup> rezultoi se bashkëshortja e subjekti ka qenë e punësuar:

- Pranë Q.E.A.Q Tiranë, mësuese në dispozicion për periudhën Shkurt 2000 - Shtator 2003 dhe ka pasur të ardhura neto në shumën 274 412 lekë.
- Pranë Q.E.A.Q, Shkolla “M. Keta” për periudhën Dhjetor 2003 - Qershor 2007 dhe ka pasur të ardhura neto në shumën 900 189 lekë.
- Pranë Kolegjtit \*\*\*\*\* për periudhën Dhjetor 2007 - Shtator 2013 dhe ka pasur të ardhura neto në shumën 2 454 284 lekë.

Bazuar në të ardhurat nga burime të ligjshme të familjes së subjektit të vlerësimit për periudhën 2003 - 2008 dhe shpenzimet sipas shkresës së INSTAT me 1664/1prot, datë 26.08.2019, rezultoi si më poshtë:

<sup>5</sup> shkresa nr.\*\*\*\*\* prot, datë 26.09.2019

<sup>6</sup> shkresa nr.\*\*\*\* Prot, datë 31.07.2019.

<sup>7</sup> shkresa nr.\*\*\* Prot, datë 01.07.2019.

<sup>8</sup> shkresa nr.\*\*\* Prot, datë 18.07.2019.

<sup>9</sup> shkresa nr.\*\*\* Prot, datë 18.07.2019.

	2003	2004	2005	2006	2007	2008	Total
Të ardhura nga pagat O.Shehu	104.212	32.487		376.698	359.431	155.248	1.028.076
Të ardhura nga pagat A.Shehu	40.091	196.370	190.432	309.760	278.978	414.531	1.430.162
Totali i të ardhurave	144.303	228.857	190.432	686.458	638.409	569.779	2.458.238
Shpenzime jetese	281.592	281.592	328.671	328.671	943.872	546.480	2.710.878
Totali i shpenzimeve	281.592	281.592	328.671	328.671	943.872	546.480	2.710.878
Diferenca	- 137.289	52.735	- 138.239	357.787	- 305.463	23.299	- 252.640

Nga analiza financiare rezultoi se subjekti i vlerësimit nuk justifikon me të ardhura nga burime të ligjshme për periudhën 2003 – 2008, krijimin e kursimeve familjare në vlerën 2 500 000 lekë, për ndërtimin e shtëpisë.

Këto rezultate të analizës financiare iu komunikuan subjektit të vlerësimit, ndaj të cilave subjekti ngriti pretendimet se:

*1. Unë kam qenë i punësuar por nuk kam qenë i siguruar dhe nuk kam dokumentacion ligjor nga ISSH për kontribute, apo librezë të firmosuar apo vulosur nga pronarët e aktivitetve tregtare ku kam qenë i punësuar. Për të vertetuar punësimin, unë kam sjellë disa deklaratatë të kolegëve të mi në atë periudhë. Nga shkurti i vitit 1996 deri në gusht të vitit 1997, kam punuar pranë Bingo “\*\*\*\*\*”, aktivitet i lojrave të fatit. Për periudhën 1 vit e 5 muaj kam krijuar të ardhura prej 2.250.000 lekë nga të cilat 450.000 lekë të ardhura nga paga ime si Shef i Kasës (Arkës), dhe 1.800.000 lekë të ardhura nga bakshishet. Duke zbritur shpenzimet familjare, për periudhën 1996 deri në fund të vitit 1999, vlerësoj se para të kursyera nga ana ime për këtë periudhë kanë qenë 1.000.000 lekë. Nga viti 2000 deri në muajin prill të vitit 2003 kam qenë i punësuar pranë “\*\*\*\*\*” shpk “\*\*\*\*\*”, në pozicionin e kamarierit. Për 26 muaj kam përfituar të ardhura në vlerën 1.690.000 lekë (pagë dhe bakshishe). Në periudhat qershor-shtator 2003 dhe qershor-shtator 2004 kam punuar në pozicionin e manaxherit dhe kryemenaxherit në \*\*\*\*\* Golem Kavajë, edhe kjo pronë e “\*\*\*\*\*” shpk dhe kam përfituar të ardhura në vlerën 1.360.000 lekë (pagë dhe bakshishe). Për të gjithë kohën që kam punuar pranë “\*\*\*\*\*” shpk, nga viti 2000 deri në vitin 2004, kam përfituar në total 3.050.000 lekë.*

*2. Duke shqyrtuar tabelën e të ardhurave dhe shpenzimeve, më duket totalisht e palogjikshme se meqënëse për vitet 2000, 2001 dhe 2002, INSTAT nuk ka një tabelë për mënyrën e llogaritjes së shpenzimeve familjare dhe për këto tre vite nuk më janë shënuar shpenzimet familjare.*

3. Siç duket ka një mospërputhje dhe një paradoks në vitin 2007, pasi nga ana e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit është arritur në përfundimin se shpenzimet janë 943.872 lekë, por kjo shumë nuk përputhet me tabelën e përlllogaritjes nga ana e këtij institucioni, pasi në këtë të fundit shpenzimet për vitin 2007 janë në shumën 707,904.00 lekë. Shpenzimet e vitit 2017 janë 970,500.00 lekë, pra ka një disbalancë thelbësore, pasi nuk mundet që shpenzimet e vitit 2007 të jenë pak a shumë me ato të viti 2017, duke llogaritur këtu nivelin e jetesës, inflacionin, numrin e anëtarëve të familjes, kjo e fundit theksohet pasi djali është i datëlindjes 23.12.2006 dhe nuk mundet të jenë shpenzimet njësoj edhe kur nuk ka mbushur 1 vjeç dhe kur është 11 vjeç.

4. Ndërtimi i shtëpisë ka përfunduar në vitin 2008. Pra siç shihet kjo është një pasuri e vënë shumë kohë përpara se unë të bëhesha pjesë e SHÇBA-së. Neni 32, pika 1, e ligjit nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brednshme dhe Ankesat”, të ndryshuar, përcakton se: “Punonjësi deklaron çdo pasuri, të luajtshme apo të paluajtshme, të fituar, poseduar, përdorur apo tjetërsuar që nga data e fillimit të marrëdhënies së punës në institucionin përkatës, pavarësisht datës së emërimit në pozicionin dhe/ose gradën që mban, deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij ligji. Ky deklarim fillon ditën e parë të marrëdhënies së punës”.

Në interpretim të kësaj dispozite është e qartë se subjekti i vlerësimit ka detyrimin të deklarojë çdo pasuri të fituar, poseduar, përdorur apo tjetërsuar nga data e fillimit të marrëdhënies së punës në institucionin përkatës, pra do të thotë se objekt verifikimi nga ana e këtij Komisioni, është çdo pasuri e vendosur pas momentit të fillimit të marrëdhënies së punës, pra konkretisht pas datës 28.04.2014, kur jam emëruar Specialist në Sektorin e Inspektimit në SHÇBA. Deklarimet për çdo pasuri i kemi bërë nëpërmjet formularve të dorëzuar, por kërkesa për të shpjeguar të ardhurat dhe shpenzimet për një kohë në të cilën unë nuk kam qenë pjesë e SHÇBA-së, më duket e tepërt, jo vetëm për kohën e gjatë që ka kaluar, pamundësinë e gjetjes së dokumentave por edhe ndikimin në bilancin aktual, pasi që nga koha që jam bërë pjesë e SHÇBA-së, unë nuk kam levizje të interesave financiar (shtetsa/pakësime) përveç blerjes së një automjeti, edhe ky i blerë me kredi.

Në këto kushte unë e shoh si ekstra ligjore kërkesën tuaj për burimet e të ardhurave dhe vlerësimin mbi të ardhurat dhe shpenzimet që nga viti 2000 dhe deri më sot.

Komisioni, pasi shqyrtoi pretendimet, shpjegimet dhe provat e subjektit të vlerësimit, konstaton se:

- Në lidhje me pretendimin se, kam qenë i punësuar por nuk kam qenë i siguruar, subjekti e pohon vetë edhe në shpjegimet e tij se nuk arrin të justifikojë me dokumentacion ligjor burimet e ligjshme financiare të kursimeve familjare. Nga përlllogaritjet e bëra nga Komisioni për të ardhurat nga burime të ligjshme dhe nivelit të shpenzimeve duke iu referuar të dhënave të INSTAT, dërguar pranë Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit me shkresën nr.1664/1prot, datë 26.08.2019, rezulton se në vitin 2008 familja e subjektit ka diferencë negative të fondeve në vlerën 252 640 lekë.



- Në lidhje me pretendimin se, për vitet 2000, 2001 dhe 2002, INSTAT nuk ka një tabelë për mënyrën e llogaritjes së shpenzimeve familjare dhe për këto tre vite nuk më janë shënuar shpenzimet familjare, Komisioni konstaton se nuk janë përlllogaritur shpenzimet familjare për periudhën 2000-2003 për arsye të nivelit të ulët të të ardhurave nga burime të ligjshme të cilat për këtë periudhë rezultuan të ishin në shumën 288 662 lekë. Nisur nga niveli i ulët i të ardhurave nga burime të ligjshme u konkludua se në vitin 2003 familja e subjektit nuk ka pasur kursime për të filluar ndërtimin shtëpisë.

- Në lidhje me pretendimin se, ka një disbalancë thelbësore pasi nuk mundet që shpenzimet e vitit 2007 të jenë pak a shumë me ato të viti 2017, Komisioni konstaton se përlllogaritja e shpenzimeve është bazuar në të dhënat zyrtare të INSTAT të vitit 2007, sipas të cilave rezulton se shpenzimet mesatare vjetore të konsumit për frymë janë 235 968 lekë. Familja e subjektit të vlerësimit në vitin 2007 përbëhej nga katër anëtarë dhe shpenzimet për këtë vit janë:  $235\,968 \times 4 = 943\,872$  lekë.

- Në lidhje me pretendimin se, subjekti i vlerësimit ka detyrimin të deklarojë çdo pasuri të fituar, poseduar, përdorur apo tjetërsuar që nga data e fillimit të marrëdhënies së punës në institucionin përkatës dhe objekt verifikimi nga ana e Komisionit është çdo pasuri e vendosur pas momentit të fillimit të marrëdhënies së punës, pra pas datës 28.04.2014, kur subjekti është emëruar Specialist në Sektorin e Inspektimit në SHÇBA, Komisioni konstaton se subjekti i vlerësimit ka filluar ndërtimin e shtëpisë në vitin 2003 në mënyrë të paligjshme në truall shtetëror dhe e ka përfunduar në vitin 2008. Në datën 28.04.2014, kur është emëruar Specialist në Sektorin e Inspektimit në SHÇBA, subjekti i vlerësimit e ka poseduar këtë shtëpi.

Pas fillimit të marrëdhënies të punës në SHÇBA, me datë 28.07.2015, subjekti i vlerësimit ka nënshkruar kontratën e kalimit të pronësisë të parcelës ndërtimore me Agjencinë e Legalizimit, Integritimit dhe Urbanizimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI). Sipas nenit 83 të Kodit Civil, *“Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohët, përndryshe nuk është i vlefshëm”*. Me datë 02.08.2019, është lëshuar Çertifikata e pronësisë së ndërtesës për subjektin e vlerësimit.

Për sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i vlerësimit ka fituar pronësinë e shtëpisë pas fillimit të marrëdhënies të punës në SHÇBA dhe në momentin e plotësimit të deklaratës Vetting 2018, subjekti kishte detyrimin ligjor të deklaronte këtë shtëpi sipas parashikimeve të nenit 32, pika 1, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar.

Sipas nenit 31 të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, *objekt i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për punonjësin dhe personat e lidhur me të.*

Në ndryshim nga neni 32, pika 1, e Ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, që kërkon deklarimin e çdo pasurie të luajtshme apo të paluajtshme, të fituar, poseduar, përdorur apo tjetërsuar që nga data e fillimit të marrëdhënies së punës në institucionin përkatës, neni 31 *nuk përcakton asnjë kufizim që kontrolli i ligjshmërisë së burimeve financiare për pasuritë e deklaruara nga subjekti i vlerësimit, duhet bërë pas datës së fillimit të marrëdhënies të punës dhe as nuk e përjashton kontrollin e ligjshmërisë së burimeve financiare përpara fillimit të detyrës.*

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni konkludon:

- ✓ *Nisur nga dokumentacioni ligjor i të ardhurave nga burime të ligjshme, si dhe nga shpenzimet e jetesës, familja e subjektit të vlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të kursyer shumën 2.500.000 lekë për ndërtimin e shtëpisë.*
- ✓ *Në momentin e plotësimit të deklaratës Vetting 2018, subjekti i vlerësimit e ka poseduar pasurinë. Në vitin 2015 ka kryer veprimin e parë juridik për kalimin e pronësisë dhe në vitin 2019 është bërë pronar i ligjshëm i kësaj pasurie. Këto veprime juridike kanë ndodhur pas fillimit të mardhënieve të punës të subjektit të vlerësimit në SHÇBA dhe sipas përcaktimeve të nenit 32, pika 1<sup>10</sup>, të ligjit 12/2018, të ndryshuar, subjekti kishte detyrimin ligjor të deklarimit të kësaj pasurie.*
- ✓ *Në kuptim të nenit 3, pika 11 dhe nenit 31 të ligjit 12/2018, të ndryshuar, çdo pasuri që është objekt deklarimi në deklaratën e pasurisë vetting, i nënshtrohet kontrollit të plotë mbi vërtetësinë, saktësinë e deklarimit dhe ligjshmërinë e burimeve të krijimit, pa asnjë kufizim apo përjashtim për kohën e burimeve financiare të krijimit të tyre.*
- ✓ *Për më tepër, nga interpretimi i nenit 3, pika 11, nenit 32, pika 1, si dhe nenit 34, pika 1, të ligjit 12/2018, të ndryshuar, trupi vlerësues arrin në konkluzionin se standardi i vendosur për vlerësimin e pasurisë, kërkon kontrollin e plotë të burimeve të ligjshme financiare për pasuritë e deklaruara.*
- ✓ *Gjithashtu, në një interpretim të dispozitave të zbatueshme për vlerësimin e pasurive dhe të nenit 1 të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, trupi vlerësues arrin në konkluzionin se, nëpërmjet procedurës së kontrollit të pasurive, synohet identifikimi i atyre subjekteve të vlerësimit, të cilët janë bërë përfutues apo përdorues të pasurive në mënyrë të paligjshme apo me të ardhura, ligjshmëria e të cilave, vihet në dyshim, pavarësisht nëse ky fakt nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin e detyrës së subjektit, apo rezulton të ketë ndodhur jashtë periudhës kohore të ushtrimit të saj.*
- ✓ *Konfirmimi i një marrëdhënieje të tillë të një punonjësi në raport me ligjin, qoftë në formën e veprimeve të tij në kundërshtim me ligjin, apo edhe në formën e pranimit të veprimeve të personave të lidhur me të, çënon vlerat themelore të tij, si rrjedhojë, edhe besimin që ai duhet të përcjellë te publiku në përmbushjen e misionit/rolit të tij zyrtar.*
- ✓ *Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit të vlerësimit, trupi vlerësues nuk pranon si argumentim bindës, qëndrimin e subjektit se nuk duhen vlerësuar burimet e ligjshme financiare para fillimit të detyrës, për aq kohë sa në themel ligjit 12/2018 të ndryshuar, është qëllimi për të siguruar institucione të forta e të besueshme, me profesionistë me integritet.*

**2. Autoveturë tip Mercedes Benz/203, C 220 CDI, me targa TR\*\*\*\*S, viti i prodhimit 2000. blerë me datë 2.03.2015.**

---

<sup>10</sup> Neni 32, pika 1, parashikon:

1. "Punonjësi deklaron çdo pasuri, të luajtshme apo të paluajtshme, të fituar, poseduar, përdorur apo tjetërsuar që nga data e fillimit të marrëdhënies së punës në institucionin përkatës, pavarësisht datës së emërimit në pozicionin dhe/ose gradën që mban, deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij ligji. Ky deklaram fillon ditën e parë të marrëdhënies së punës"

- ✓ Burimi i krijimit: Kredi banka Societe Generale, shuma 816 000 lekë.
- ✓ Vlera: 4 000 Euro (Katër mijë).
- ✓ Pjesa në %: 100 %.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës;

- ✓ kontratë me nr.Rep \*\*\*\* dhe nr.\*\*\*\*\* Kol, Kontratë shitblerje pasuri e luajtshme.
- ✓ kontratë kredie me Bankën Societe Generale Albania datë 06.02.2015.

Nga hetimi administrativ rezultoi:

DPSHTRR<sup>11</sup> informon se në emër të subjektit të vlerësimit janë të regjistruara automjetet me targë AA \*\*\*\*\* JX, TR \*\*\*\*\* S, si dhe ka bashkëlidhur dosjet e plota të automjeteve.

Në dokumentacionin e ardhur nga DPSHTRR për automjetin me targë AA \*\*\*\*\* JX, Komisioni konstatoi se subjekti i vlerësimit e ka shitur këtë makinë në vitin 2014. Për këtë arsye Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit<sup>12</sup> kërkoi rikonfirmim pranë DPSHTRR për makinën me targë AA \*\*\*\*\* JX, lidhur me shtetasin që rezulton të jetë pronar i kësaj makine.

DPSHTRR<sup>13</sup> informon Komisionin se mjeti me targë AA \*\*\*\*\* JX, figuron i regjistruar në pronësi të shtetasit E.M.

Lidhur me burimet e krijimit të pasurisë nga hetimi administrativ rezultoi:

Banka OTP Albania<sup>14</sup> (ish Banka Societe Generale), konfirmon kredinë e marrë nga z. Shehu në shumën 816 000 lekë.

Në përfundim të hetimit Komisioni konkludoi:

- ✓ *Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar dhe përgjigjet e ardhura nga institucionet. Nga dokumentacioni zyrtar i administruar nga Komisioni gjatë hetimit rezulton se subjekti justifikon burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie në momentin e fitimit.*

3. Para cash, jashtë sistemit bankar vlera 250 000 lekë (dyqind e pesëdhjetë mijë), burimi i krijimit, nuk është deklaruar, pjesa në %: 100 %.

Nga përlllogaritjet e gjendjes së likuiditetit në momentin e plotësimit të deklaratës, justifikohet kjo gjendje likuiditeti.

<sup>11</sup> shkresa nr.\*\*\*\* datë 05.07.2019.

<sup>12</sup> shkresa nr.\*\*\*\* prot, datë 06.09.2019.

<sup>13</sup> shkresa nr.\*\*\*\* prot, datë 13.09.2019

<sup>14</sup> shkresa nr.\*\*\*\* prot, datë 05.07.2019

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

Për vlerësimin e figurës së subjektit të vlerësimit, është kryer një proces i mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi, duke bërë verifikimin e deklarimeve të subjektit, për të vertetuar saktësinë dhe besueshmërinë e tyre, si dhe identifikimin e atyre që janë përfshirë apo kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në veprimtari kriminale.

### Konstatim për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vertetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas rrethanave të parashikuara në nenin 39, pika 4, të ligjit 12/2018, të ndryshuar.

Trupi vlerësues gjykon se subjekti i vlerësimit, z. Oltion Shehu, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, pika 1 e nenit 60, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

Në përputhje me nenin 38, pika 2 e ligjit 12/2018, të ndryshuar, subjekti iu nënshtrua testit psikologjik të personalitetit dhe rezultoi se:

- Nuk paraqet probleme të shëndetit mendor, ndaj është mendërisht i aftë të funksionojë në aspektin okupacional, ndërpersonal dhe social.
- Paraqet marrdhënie të stabilizuara personale dhe ndërpersonale.
- Nuk paraqet problematika të personalitetit, që mund të çojnë plotësimin e detyrimeve dhe aktivitetin e tij në tërësi si dhe shfaq shkallë të lartë të funksionimit në plotësimin e këtij aktiviteti.

## **C. VLERËSIMI PROFESIONAL**

Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit mbështetet në informacionin e marrë në nga SHÇBA, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe nga burime të tjera për nivelin e arsimimit në përputhje me pozicionin e punës, aftësinë për përmbushjen e detyrave, respektimin e rregullave të etikës në përputhje me ligjin nr.12/2018 të ndryshuar, dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

### Përvoja profesionale

Subjekti ka filluar punë pranë SHÇBA me datë 28.04.2014, në funksionin Inspektor në Sektorin e Inspektimit, në Drejtorinë e Inspektimit të Ankesave në SHCBA. Me datë 18.02.2015 është emëruar Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit të Ankesave në SHÇBA.

Pas fillimit të hetimit Administrativ nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, subjekti ka kërkuar dorëheqjen nga pozicioni i Drejtorit të Inspektimit të Ankesave në SHÇBA, *duke argumentuar në kërkesën për dorëheqje se në shumë raste atij i është tërhequr vëmendja nga Drejtori i Përgjithshëm dhe zv.Drejtori i SHÇBA, për cilësinë e dobët në administrimin dhe përpunimin e materialeve, për raportet e inspektimit që kanë qenë të një cilësie të dobët me konkluzione dhe*

*rekomandime pa vlerë. Në lidhje me këto mangësi ai argumenton se vijnë nga shkaqe që lidhen vetëm me aftësitë profesionale në punë dhe aspak nga shkaqe që lidhen me neglizhencën dhe abuzimin me detyrën.*

*Më tej subjekti shprehet në kërkesën e tij për dorëheqje se nuk mendon se ka aftësitë e duhura dhe kapacitetin për të ndjekur dhe përballuar volumin e punës dhe ritmin shumë të lartë që ka përcaktuar Titullari i institucionit duke kërkuar të emërohet në një pozicion specialisti.*

Me datë 20.06.2019, është emëruar në pozicionin e Specialistit të Analizës dhe Kartotekës në Drejtorinë e Hetimit në SHÇBA.

➤ Niveli i arsimimit dhe trajnimi në përputhje me pozicionin:

1. Subjekti është diplomuar në fakultetin e Ekonomisë, dega Financë, Universiteti i Tiranës në vitin 2005. Niveli i arsimimit është në përputhje me pikën 2 të nenit 77 të ligjit nr.70/2014, “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme”.

2. Subjekti në momentin e emërimit në SHÇBA nuk ka pasur vjetërsinë e duhur në punë, por në muajin prill 2014 ka përfunduar “Trajnimin bazë të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm”, në përputhje me pikën 1 të nenit 82 të ligjit nr.70/2014, “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme” dhe me pikën 3 të nenit 59 të VKM nr.829, datë 03.12.2014, “Për miratimin e rregullores së Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”.

➤ Trajnime profesionale

Gjatë viteve të punës në SHÇBA subjekti është angazhur në aktivitete profesionale. Ai u ka kushtuar rëndësi trajnimeve që kanë të bëjnë me objektivitetin e tij të punës.

➤ Respektimi i rregullave të etikës dhe përmbushja e detyrave

Subjekti i vlerësimit nuk ka marrë asnjë masë disiplinore për periudhën e punës 2014-2018.

Sipas vlerësimeve të punës të kryera nga Drejtuesit e SHÇBA rezultoi se subjekti i vlerësimit në funksionin Inspektor është vlerësuar në kategorinë shumë mirë: për integritet të lartë, aftësi shumë të mira për punë në grup, me profesionalizëm të lartë, aftësi të shkëlqyera komunikimi me kolegë, epror, vartës.

Për vitet 2015, 2017 është vlerësuar në kategorinë shumë mirë: për aftësi shumë të larta drejtuese, gjykuese, aftësitë e hetimit administrativ, penal etj, aftësitë informativo-gjurmuese, aftësi për punë në grup, aftësi komunikimi me kolegë, epror, vartës.

SHÇBA<sup>15</sup> informoi Komisionin se për vitet 2016, 2018, pozicioneve të Drejtorit të Drejtorisë, nuk u janë kryer Vlerësimet Individuale të Punës.

---

<sup>15</sup> shkresa nr. \*\*\*\*\*, datë 22.08.2019

Në 3 dokumente zyrtare (Urdhëra) të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i SHÇBA, të paraqitur për vlerësim nga subjekti i vlerësimit, konstatohet se gjatë viteve të punës si drejtor ai ka qenë anëtar i grupeve të punës për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm.

*Subjekti nuk ka bashkëlidhur për vlerësim asnjë dokument të përgatitur nga vetë ai që trupa e vlerësimit të ketë mundësinë të shprehet nëse subjekti i ka përbushur detyrat brenda afatit të përcaktuar në këto urdhëra.*

Subjekti i vlerësimit ka vetdeklaruar se është angazhuar në grupe pune si: në grupin e punës për hartimin e Ligjit 70/2014; në grupin e punës për hartimin e Rregullores së Shërbimit, e miratuar me VKM nr.829, datë 03.12.2014; në grupin e punës për përgatitjen e draft-protokolleve të punës për çdo funksion organik të strukturave të Shërbimit; në grupin e punës për ndryshimet e protokollit të punës për trajtimin e ankesave.

*Për këto angazhime subjekti nuk ka paraqitur për vlerësim asnjë dokument ku të kuptohet kontributi i subjektit në hartimin e këtyre drafteve si anëtar i grupeve të punës.*

Meqenëse subjekti që nga data 20.06.2019, ka mbuluar pozicionin e Specialistit në Sektorin e Analizës dhe Kartotekës në Drejtorinë e Hetimit, trupi vlerësues gjykoi si të domosdoshme aftësinë profesionale të subjektit të vlerësimit në realizimin e detyrave në pozicionin aktual. Trupi vlerësues i kërkoi subjektit përshkrimin e detyrave të vendit të punës dhe nëse ka materiale të përgatitura nga vetë ai në pozicionin specialist.

Subjekti në e-mail-in e datës 20.09.2019, sqaroi Komisionin se nuk është në pozicionin specialist në Sektorin e Analizës dhe Kartotekës, për arsye se është transferuar më datë 08.08.2019, me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të SHÇBA, në detyrën e Shefit të Sektorit për Trajtimin e Ankesave në Drejtorinë Rajonale të SHÇBA Tiranë dhe paraqiti për vlerësim tre relacione të përgatitura nga specialistët e Sektorit të Trajtimit të Ankesave në Drejtorinë Rajonale Tiranë, të cilat i ka firmosur me cilësinë e Shefit të Sektorit.

Gjithashtu subjekti sqaroi se me Strukturën Organike të SHÇBA të vitit 2018<sup>16</sup>, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Brendshëm, është hapur për herë të parë pozicioni i Shefit të Sektorit për Trajtimin e Ankesave në Drejtorinë Rajonale Tiranë. Protokollet e punës, për të gjitha funksionet organike në SHÇBA, janë miratuar në vitin 2016, me Urdhër të Ministrit të Brendshëm dhe rrjedhimisht nuk ka një përshkrim pune për funksionin e Shefit të Sektorit për Trajtimin e Ankesave.

Këto rezultate të vlerësimit profesional iu komunikuan subjektit të vlerësimit, ndaj të cilave subjekti ngriti pretendimin se:

*- Në kërkesën për dorëheqje kam pasë në konsideratë volumin dhe ritmin shumë të lartë të punës të parcaktuar nga drejtuesit e Shërbimit, por duke marrë në konsideratë edhe kapacitetet dhe*

---

<sup>16</sup> Urdhëri nr.\*\*\*, datë 26.10.2018, i Ministrit të Brendshëm “Për miratimin e stukturës dhe përbërjes organike të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”.

*burimet njërzorë të Drejtorisë tonë. Une ë i referohem lodhjes, ngarkesës dhe kapacitetve që kjo Drejtori kishte në dispozicion dhe se është totalisht vetëm vlerësimi im personal për punën time në këto kushte, dhe jo vlerësimi i drejtuesve, të cilët në çdo rast veç kritikave të cilat kanë qenë në funksion të përmirësimit të punës, na kanë mbështetur dhe na kanë inkurajuar dhe e kanë vlerësuar punën tonë të përditshme.*

*Për të provuar këtë po ju vë në dispozicion kopje të vlerësimit të fundit të punës së bërë, e cila merr në vlerësim periudhën janar 2019 deri në qershor 2019, periudhë që më së shumti unë kam qenë në pozicionin e Drejtorit të Inspektimit dhe Ankesave (deri më datë 20.06.2019). Vlerësimi i punës, i bërë nga eprorët, është i nivelit “Mirë”, duke më vlerësuar si një punonjës me integritet të lartë, dhe me aftësi të mira drejtuese, gjykuese. Sipas tyre në këtë vlerësim punë, gjatë kësaj periudhe 6 mujore, kam prezantuar aftësi në hetimin administrativ, penal etj, aftësi të mira për punë në grup, aftësi të mira komunikimi me koleg, epror dhe vartës si dhe nuk kam patur asnjëherë masa disiplinore.*

Komisioni, pasi analizoi veprimtarinë profesionale, shqyrtoi pretendimet, provat dhe shpjegimet e subjektit të vlerësimit, konstaton se:

- ✓ Si anëtar i grupeve të punës ku është angazhuar, subjekti i vlerësimit nuk arriti të provonte kontributin konkret të tij për hartimin e dokumenteve ose projektakteve ligjore e nënligjore sipas kërkesave të nenit 45, pika 2, gërmat “iii”, “iv”, “v”, “vi, të ligjit 12/2018, të ndryshuar.
- ✓ Nga relacionet e paraqitura nga subjekti i vlerësimit rezulton se ai ka firmosur në cilësinë e Shefit të Sektorit. Për periudhën e punës në SHÇBA nga data 28.04.2014 deri në datën e seancës dëgjimore subjekti i vlerësimit nuk paraqiti asnjë dokument zyrtar të përgatitur nga ai sipas kërkesave të nenit 46, pika 3 e ligjit 12/2018, të ndryshuar.
- ✓ Mungesa e përvojës profesionale në momentin e hyrjes në punë pranë SHÇBA-së, ngritja në detyrën e drejtorit pas një përvoje të shkurtër (10 muaj) si Inspektor, ka sjellë si pasojë cilësinë e dobët në administrimin dhe përpunimin e materialeve dhe raporte inspektimi me konkluzione dhe rekomandime pa vlerë.
- ✓ Nisur nga fakti se nuk ka një përkrahje pune për funksionin e Shefit të Sektorit për Trajtimin e Ankesave në Drejtorinë Rajonale të SHÇBA-së Tiranë, për arsye se ky pozicion pune është hapur për herë të parë në strukturën organike të këtij institucioni në vitin 2018, trupi vlerësues konkludon se subjekti i vlerësimit nuk ka përvojën dhe nivelin e duhur profesional për të menaxhuar dhe organizuar punën e këtij sektori dhe për rrjedhojë nuk mund të jetë i përshtatshëm për të kryer detyrën e Shefit të Sektorit të Ankesave në Drejtorinë Rajonale të Tiranës.
- ✓ Për më tepër, trupi vlerësues gjykon se ushtrimi i detyrës Shef i Sektorit për Trajtimin e Ankesave, në Drejtorinë Rajonale të SHÇBA Tiranë, pas një periudhe një muaj e gjysëm nga dorëheqja, nuk garanton realizimin e detyrave që i ngarkohen me një cilësi të lartë, me

konkluzione dhe rekomandime të vlefshme, për aq kohë sa nuk ka ndjekur një kurs për ngritjen e aftësive profesionale.

Në vijim të sa më sipër trupi vlerësues gjykon se ushtrimi i kësaj detyre nga subjekti i vlerësimit e cënon dhe nuk justifikon qëllimin e nenit 2 të ligjit 12/2018, të ndryshuar, sipas të cilit vlerësimi kalimtar dhe periodik i punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, duhet të sigurojë institucione të forta e të besueshme, me profesionistë me integritet”.

Në përfundim të vlerësimit, në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit të vlerësimit, z. Oltion Shehu, trupi vlerësues konkludon se subjekti ka mangësi të aftësive profesionale për zbatimin e përshkrimeve të punës, të përcaktuara për atë funksion, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 47 pika 1, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

#### **D. KONKLZIONI PËRFUNDIMTAR**

Trupi vlerësues i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi përfaqësuesin ligjor të subjektit të vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara prej tij, konstaton se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë dhe ka mangësi të aftësive profesionale për zbatimin e përshkrimeve të punës për atë funksion.

#### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi vlerësues i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në bazë të germës “ç”, të nenit 59, si dhe, të germës “ç”, të nenit 62, të ligjit nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar,

#### **V E N D O S I:**

1. Përgjashtimin nga detyra të subjektit të vlerësimit, znj. Oltion Shehu, me funksion Shef i Sektorit për Trajtimin e Ankesave në Drejtorinë Rajonale të SHÇBA, Tiranë.
2. Vendimi i njoftohet me shkrim subjektit të vlerësimit brenda 15 ditëve pas përfundimit të kësaj seance dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar.
3. Ky vendim ankimohet pranë Gjykatës Administrative kompetente, sipas legjisllacionit në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 8.11.2019.



## ANËTARËT E TRUPIT VLERËSUES

Ela Kerka  
Kryesuese

Marjeta Gjellaj  
Relator

Ana Kapaj  
Anëtar